



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:034429

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396915

NE ËMËR TE POPULLIT

P.nr.560/15

GJYKATA THEMELORE PEJË- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Teuta Spahija në çështjen penale kundër të pandehurve B. K. , A. G. , B. S. dhe E. K. të gjithë nga Peja, secili veç e veç, për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtëshme nga neni 332 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP.nr.738/15 të datës 19.08.2025, në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datat 05.12.2023, 18.12.2023, dhe 07.02.2024, të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit B. K. , A. G. , B. S. me mbrojtësin e tij Av.Xhelal Radoniqi, i pandehuri E. K., si dhe përfaqësuesja e KK-Pëjë – Shëndritë Muriqi, me datë 07.02.2024 shpalli, ndërsa me datë 27.02.2024 përpiloj këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit :

1. B. K. , i biri i J. dhe nenës S., i lindur me date ..... në Peje, ku edhe banon në rr. "12.Q. ...", nr. ..., me profesion profesor, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka te kryer fakultetin e arteve, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në baze të letërnjoftimit t me nr....., posedues i numrit të tel. 049/...-..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.
2. A. G. , i biri i S., nenës S. e vajzërisë M., i lindur me dt. .... në Peje, ku edhe banon në rr. "12.Q. ...", nr..., me profesion automekanik, i martuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr.Inj....., posedon telefonin me nr.044/...-..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri..

3. B. S., i biri i I. dhe i nenës H. e vajzërisë Tabaku, li lindur me dt.24.10.1947, ne Peje, ku edhe banon ne rr. "12.Q. ...", nr., i martuar, baba i tre fëmijëve, me profesion pensioner, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me nr. personal ....., posedon nr.tel. 049/...-..., shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, mbrohet ne liri.
  
4. E. K., i biri i M., nenës H. e vajzërisë B., i moshës madhore, i lindur në Peje ku edhe banon në rrugën "I. B.", nr..., i martuar, i gjendjes se mesme ekonomike, posedon tel. 044/...-..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

### I. LIROHEN NGA AKUZA

Për shkak se :

I pandehuri B. K.

Me datën 11.12.2014, e gjerë me tani, në lokacionin M. e Z., K. Peje, pikërisht në rr. "12 Q.", ne mënyrë te kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme te të dëmtuarës Kuvendit Komunal - Pejë, ne atë mënyrë qe i pandehuri është futur në posedim te patundshmërisë te evidentuar në certifikatën e pronës me nr. I 6/... 1, ZK. Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. .../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 55m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara ka konstatuar dhe njoftuar te pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

-me çka kishte për të kryer vepren penale Uzurpim i paligjshme i pronës se paluajtshme nga neni 332 par.2 të KPRK-së.

I pandehuri A. G.

Me datën 11.12.2014, e gjerë më tani, në lokacionin M. e Z., K Pejë, pikërisht në rr." 12 Q.", ne mënyrë te kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme te të dëmtuarës Kuvendit Komunal - Pejë, në atë mënyre që i pandehuri është futur ne posedim të patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. 16/... ZK Pejë dhe atë te ngastrës kadastrale nr...../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 80m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara ka konstatuar dhe njoftuar te pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 të KPRK-së.

I Pandehuri B. S.

Me datë 11.12.2014, e gjere me tani, në lokacionin M. e Z., K Pejë, pikërisht në rr. " 12 Q.", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të të dëmtuarës Kuvendit Komunal - Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri është futur në posedim të patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. .... ZK Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. .../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 74m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara e ka konstatuar dhe njoftuar të pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje të njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

-me çka kishte për të kryer veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 të KPRK-së.

I pandehuri E. K.

Me datë 11.12.2014, e gjerë më tani, në lokacionin M. e Z., K Pejë, pikërisht në r." 12 Q.", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme të të dëmtuarës Kuvendit Komunal - Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri është futur në posedim të patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. .... ZK Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. ..../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 55m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara e ka konstatuar dhe njoftuar të pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje të njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar,

-me çka kishte për të kryer veprën penale Uzurpim i paligjshme i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 të KPRK-së.

II. Shpenzimet e procedurës mbeten në barrën e mjeteve buxhetore të gjykate.

ARSYETIM

a) Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pejë pranë kësaj gjykatë ka parqitur aktakuzën PP/II.nr.738/15 të datës 19.08.20215, të pandehurve B. K. , A. G. , B. S. dhe E. K. të gjithë nga Peja, secili veç e veç, për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajteshme nga neni 332 par.2 të Kodit të Penal të Republikës së Kosovës .

Gjykatat e mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor në disa data dhe atë me datë 05.12.2023, 18.12.2023, dhe 07.02.2024., në të cilën seancë prezentuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri B. K. , A. G. , B. S. me mbrojtësin e tij Av.Xhelal Radoniqi, i pandehuri E. K., si dhe përfaqësuesja e KK-Pëjë – Shëndritë Muriqi.

Me qëllim të vërtetimit të veprës penale përkatësisht fakteve të përshkruara në aktakuzë, gjykata e beri administrimin e provave materiale të propozuara nga palët dhe dëgjoi dëshmitariët e prokurorisë dhe të pandehurit, ku pas vleresimit të këtyre provave gjykata e nxori përfundimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsyet që do të paraqitën në vijim të këtij aktgjykimi.

**b) Faktët e çështjës (pretendimet e akuzës ) ;**

Prokurori i Shtetit në aktakuzën që është objekt shqyrtimi në këtë procedurë penale, pretendon se të i pandehuri B. K. nga data 11.12.2014, e gjerë me tani, në lokacionin M. e Z., K. Peje, pikërisht në rr. "12 Q.i", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajteshme të të dëmtuarës Kuvendit Komunal -Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri është futur në posedim të patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. I 6/...1, ZK. Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. ..../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 55m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara ka konstatuar dhe njoftuar te pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

I pandehuri A. G. nga data 11.12.2014, e gjerë më tani, në lokacionin M. e Z., K Pejë, pikërisht në rr." 12 Q.", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajteshme të të dëmtuarës Kuvendit Komunal -Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri është futur në posedim të patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. 16/.... ZK Pejë dhe atë të ngastrës kadastrale nr...../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 80m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara ka konstatuar dhe njoftuar te pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

I pandehuri B. S. nga data 11.12.2014, e gjere me tani, ne lokacionin M. e Z., K Pejë, pikërisht ne rr. ' 12 Q.", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme te të dëmtuarës Kuvendit Komunal -Pejë, në atë mënyrë që i pandehuri është futur ne posedim te patundshmërisë të evidentuar në certifikatën e pronës me nr. .... ZK Peje dhe atë te ngastrës kadastrale nr. ..../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 74m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara e ka konstatuar dhe njoftuar të pandehurin mirëpo i njëjti edhe më tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

Dhe i pandehuri E. K. nga data 11.12.2014, e gjerë më tani, në lokacionin M.e Z., K Pejë, pikërisht në r." 12 Q.", në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme te të dëmtuarës Kuvendit Komunal -Pejë, në atë mënyre që i pandehuri është futur në posedim te patundshmërisë te evidentuar në certifikatën e pronës me nr. .... ZK Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. ..../1, duke uzurpuar sipërfaqen prej 55m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 00,38.80ha, me ç'rast e dëmtuara e ka konstatuar dhe njoftuar të pandehurin mirëpo i njëjti edhe me tutje te njëjtën vazhdon ta mbaj dhe nuk e ka liruar.

Nga këto përshkrime shihet se prokuroria ka renditur faktet mbi bazën e te cilave i akuzon të pandehurit se e kanë uzurpuar pronën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke paraqitur si veprime te kryerjes faktin se të pandehurit në mënyrë të kundërligjshme pushton pronën e paluajtshme te të dëmtuarës Kuvendit Komunal -Pejë, në atë mënyre që të pandehurit janë futur në posedim te patundshmërisë te evidentuar në certifikatën e pronës me nr. .... ZK Peje dhe atë të ngastrës kadastrale nr. ..../1.

c) Baza ligjore (Vepra penale me të cilën ngarkohen të pandehurit);

Me qllim qe të sqarohet qëndrimi i gjykatës ne lidhje me fajsinë e të pandehurve, fillimisht do të bejmë një trajtim të veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit secili veç e veç, përkatësisht do të paraqesimim elementet konstituive të kësaj vepre penale, mënyrën dhe format e kryerjes së sajë.

Të pandehurit B. K. , A. G. , B. S. dhe E. K., akuzohet se secili veç e veç kanë kryer veprën penale Uzurpim i paligjëshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332 par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (04/L-082), e cila vepër në paragrafin bazë e ka këtë përshkrim:

“ Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme uzurpon pronën e paluajtshme të personit tjetër apo një pjesë të saj, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet ”.

Për tu kryer kjo veprë penale kërkohet që kryerësi i kësaj veprë penale të hyjë në posedim të pronës së paluajtshme të personit tjetër duke e pushtuar të njëjtën dhe se në momentin e hyrjes në posedim, të jetë i vetëdijshëm se nuk ka një pëlqim nga personi i tillë ose hyrja në posedim bëhet në mënyrë të kundërligjshme pa pasur ndonjë bazë.

E rëndësishme të kjo veprë penale është:

- Veprimi i hyrjes në posedim-pushtimi, si element objektiv i veprës penale dhe
- Dijenia se nuk ka bazë apo pëlqim nga personi tjetër (poseduesi i ligjshëm), si element subjektiv i kësaj veprë penale.

Të kjo veprë penale kërkohet që kryerësi i veprës penale të jetë i vetëdijshëm se është duke pushtuar pronën e paluajtshme të personit tjetër dhe se një gjë të tillë është duke e bërë në mënyrë të kundërligjshme, pa ndonjë bazë juridike në të cilën mbështet pretendimet për marrjen e kontrollit në pronën e paluajtshme.

Dihet se mbrojtja e pronësisë në parim bëhet përmes padisë në procedurë kontetsimore e në disa raste edhe në procedurë të veçanta administrative dhe atë deri në momentet kur veprimet e penguesit ose privuesit nga posedimi nuk kanë karakter penalo juridik.

Veprimet e penguesit-privuesit, në raport me pronën e tjetrit marrin karakter penalo juridik në momentin kur kryerësi me dashje pushton pronën e tjetrit pa pasur ndonjë bazë pronësore, ndërsa në rastet tjera kur veprimet e kryerësit në raport me pronën e personit tjetër bazohen në një pretendim të caktuar pronësor, kjo situatë ka karakter juridiko-civil dhe duhet të marr mbrojtje në procedurë kontetsimore përmes padisë për pengim posedim më të cilën kërkohet kthimi i posedimit ose padisë pronësore me të cilën kërkohet lirimi i pronës nga njerëzit dhe sendet.

Gjithashtu, është me rëndësi të thuhet se personi i cili e ka vendosur posedimin në mënyrë të ligjshme edhe nëse ndërkohë e humbet bazën e posedimit, nuk mund të konsiderohet uzurpator apo pushtues i asaj paluajtshmerie, pasi që pushtimi kryhet me një akt apo veprim që ndërmerret në momentin e vendosjes së pushtetit faktik mbi paluajtshmerinë e tjetrit.

Pra si përfundim, ligjvënësi më këtë vepër ka inkriminuar aspektin subjektiv, përkatësisht dijeninë e te pandehurit se është duke pushtuar paluajtshmerinë e tjetrit pa asnjë bazë ligjore.

**d) Provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, vlerësimi dhe çmuarja e tyre;**

Gjatë shqyrtimit gjyqësor para kësaj gjykata u administruan provat materiale, ndersa sa i perket deshmitaret e propzuar në aktakuzë, prokurori heq dore që te ndegjohen të njëjtit, ndersa në cilësi të dëshmitarit të propozuar nga mbrojtësi u dëgjua: Dëshmitari Shkelqim Peteni.

Gjithashtu u administruan provat materiale si në vijim:

- Raporti i oficerit H. K. me nr rasti 2015-DA-.... i dt.20.04.2015,
- Pesë njoftimet të përshkruara si në aktakuzës nga Drejtorisë për çështje pronësore juridike, ku përshkruhen pjesët e uzurpuara të parcelës dhe personat të cilët e kanë uzurpuar pjesën e tillë,
- Kopja planit dt.23.08.2010,
- Deklarata e të dëmtuarit dëshmitarit N.K.dt.30.07.2015,
- Deklarata e dështuarit E.Sh., e dhënë në prokurori me dt.31.07.2015,
- Foto dokumentacioni,
- Raporti i ekspertizës nga eksperti gjeodet D. K.dt.17,07.2023,
- Kontrata mbi blerjen e palujtëshmërisë e lidhur ndërmjet B. S.t si shitës me blerësit F. E. dhe V.E..
- Procesverbal mbi kryerjen kontrollit i përpiluar nga Inspektorati i Komunës së Pejës me nr..... i përpiluar me dt.26.01.2024.

Dëshmitari Sh. P.i në dëshminë sajë të dhënë para gjykatës me datë 06.12.2023 deklaroi “ I pandehuri B. S. e ka angazhuar me ndërtua murin sipas pikave të vendosura nga gjeodeti, dhe kam ndërtuar murin mbrojtës-rrethues i cili mur është i lartësisë prej 80 deri 1 metër, këtë punë e kam kryer në vitin 2010 apo eventualisht në vitin 2011, këtë punë e kemi kryer në dy pozicione njëra anë ka qenë 10 deri 15 metra, e ana tjetër ka qenë e njëjtë disi si e barabartë me anën tjetër, zakonisht si procedura sa here të rrethohet diçka gjeodeti e përcakton kufirin, ne kemi punur segmentin e parë, kur e kemi kryer kemi vazhduar me segmentin e dytë në pikat të cilat i ka vendosur gjeodeti në prezencë të N. K. i cili na ka ndihmuar rreth përcaktimit të kësaj vije, pasi

ka qenë një lakesë e vogël dhe kemi vendos qe me drejtua, ndërsa B. nuk ka qenë aty kur e kemi bërë ndryshimin e vijës.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti sqaron se pas përfundimit të muri B. na ka thënë se është dashtë me më vetë mua për me ba këtë ndryshim.

Duke u përgjigjur në pyetjen e gjykatës dëshmitari deklaroi se gjeodeti i ka përcaktuar pikat ndarëse në mes të parcelave të cilat kanë qenë me shufra metali në tokë ku në mes të parcelave është ndërtuar muri, pjesa ku është ndërtuar muri nuk ka rrugë vetëm livadh ka qenë kodër, ndërsa ndryshimi që është bërë është bërë nga ana e N., e që është ana e majtë në parcelën në të cilën kam punuar.

Gjykata e vlerësoj me vëmendje dëshminë e dëshmitarit Sh. P. dhe erdhi në përfundim se të njëjtës duhet falur besimi, kjo pasi qe dëshmia e këtij dëshmitari në pjesët kryesore përputhet edhe me mbrojtjen e të pandehurit B. S., i njëjta e konfirmon se për ndërtimin e murit e ka angazhuar i pandehuri B. dhe e ka udhëzuar që murin mbrojtës të ndërton sipas pikave të caktuara, mirëpo gjatë ndërtimit të këtij muri i njëjti nuk ka qenë prezent, ku më pas është ndërtuar muri sipas kërkesës së N. K..

I pandehuri B. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi se “ Sa i përket rrethojës, pllacit unë i kam vetëm dy mure të mija të ndërtume. Shifet qartë në vizatim përkatësisht në ekspertize që e ka bërë gjykata, nuk kam mure tjera. Sa i përket çështjes së rrugës aty, deklaroj se e njëjta është mbyllur sepse ka qenë diku 10 vjet e pa mbyllur, por shkaku i lopëve që shëtitin në atë pjesë e që m kanë hy në oborr e kam mbyllë sepse më kanë krijuar dëme të mëdha në oborr, dhe kur e kemi pas padinë prej N. K., kemi pas padi pse është blloku rruga unë i kam thonë N. e ke pa vetë dëmet që mi kanë bo dhe nëse është nevoja tash në moment e qeli dhe ai më ka thonë nuk ki nevojë një herë me qel, dhe jam i gatshëm nesër atë rrugë me e hapë, sepse mes meje dhe murit të fqiu janë vetëm diku 30 cm, hapsirë, aty vetëm dera hapët dhe hapet rruga, se unë as nuk kam ndërtua diçka aty e as nuk kamë mbille diçka aty. Edhe ajo rrugë nuk i shërben asnjërit prej neve për kurgjo. Mu më vjen keq që ka ardhur deri te kjo, kur unë i kam thonë N. se a po don me ta qel qetash rrugën, edhe ai ka thonë vjen koha qe ki me e qel. Jam pjesëtar i këtij komuniteti të qytetit dhe se nuk kam pasur asnjëherë ndonjë precedent penal që me arrite deri te kjo, kjo është hera e parë dhe me vjen shumë keq nga fqiu i cili e ka ndërmarr këtë hap, ku kjo çështje ka mundur dhe është dashur të rregullohet në mes nesh, por ai ka pas pretendime tjera të cilat kanë dal në pah më vonë, ku gjithashtu ai vetë para ngritjes së çështjes në pronën gjithashtu publike ka ngritë shtyllat për ndërtimin e objektit i cili kishte me pas qasje nga kjo rrugë, besoj



se do ta merrni për bazë deklaratën time dhe arsyetimin tim, si nj pjesëtar i ndershëm i këtij komuniteti”.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti sqaron se parcela me numër të njësisë .../1 pronë e K së Pejës dhe atë në sipërfaqe prej 120 m2, është rrethi ku është dera, nuk me nevojitet për shfrytëzim mirëpo e kam rrethuar shkaku i dëmeve që më janë bërë, po ashtu ajo derë është dëmtuar nga kafshët që qarkullojnë aty dhe është mbyllur me tel që nuk hapet dhe nuk ka qasje në atë derë dhe sa i përket gjelbërimit aty ka vetëm thera, lidhur me këtë pjese kemi pasur pëlqim verbal nga ana e komunës.

Në pyetjen e gjykatës i njëjti deklaron se këtë parcelë ....25 e kam blerë dhe është në pronësi time që nga viti 2000, me dimensione 3 ari e 65 m2, si dhe me rastin e shitblerjes përkatësisht pas blerjes kanë ardhur katastri dhe i kanë vendosur pikat, pas shiqimit të skicës së majte e punuar nga gjeodeti D. Ke.i njëjti sqaron se në kohen kur e kam blerë këtë parcelë nuk ka ekzistuar rrugë fizike, bile nga rruga kryesore që ju ceket për tu futur në rrugën që ekziston në letër ka pasur një ngritje – lartës rreth 6 metra. Si dhe shton se sa i përket parcelës së të pandehurit E. K. që kufizohet me parcelën e Komunës, dyert i kam parë për here të parë kur kemi dalë në vendëshiqim, e di se dyert ku janë vendosura janë në pjesë të rrugë publike, dhe vetëm njëherë me janë kërkuar që te hekën dyert nga ana e N. po prape me ka thanë lej ashtu, duke shtuar se edhe një here që që në rast që kërkohet atë dyer i heki menjëherë.

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të pandehuri B. K. dhe erdhi në përfundim se të njëjtit duhet falur besimi, pasi qe mbrojtja e tij është në përputhje edhe me provat e tjera qe janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashti nga mbrojtja e të pandehurit B. rezulton se i njëjti nuk e konteston faktin se e ka në posedim parcela me numër të njësisë .../1 pronë e K së Pejës dhe atë në sipërfaqe prej 120 m2, është rrethi ku është dera, pasi që ka rrethuar shkaku i dëmeve që i janë bërë, mirëpo i njëjti shpreh së është i gatshëm me lirua menjëherë si të kërkohet.

I pandehuri A. G. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi së “ Unë jam një ndër të parët që e kam ble parcelën në atë pjesë, aty ka qenë kodër dhe nuk ka pas kurgjo, e kam blerë rreth vitit 1995, dhe pa vetëdije dhe pa ditur saktësisht shtrirjen e parcelës e kam ndërtuar murin provizor vetëm sa për tu mbrojtur nga kafshët që sillen aty përreth, gjithashtu siç eshë parë edhe kur kemi dal në teren aty është, teren jo i rrafshët dhe se po të mos ishte murri gjithmonë rrezikohem nga shirat dhe shembja e dheut që sillet përmes shirave, edhe ai mur që e kam vendosë i njëjti ka rrëshqitë ka ra poshtë sepse ka rrëshqitje të dheut. Edhe tash e them se në

momentin kur me kërkohet nga Komuna un jam n gjendje që menjëherë ta largoj atë murr pa asnjë problem.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti deklaron se në kohën kur e kam blerë njësit kadastrale me nr. /18 dhe /19 nuk kam qenë i vetëdijshëm se muri të cilin e kam ndërtuar ka qenë i vendosur në parcelën 5004/1 pronë e Komunës së Pejës në sipërfaqe prej 74 m<sup>2</sup>, edhe pse në atë kohë janë kryer matjet gjeodezike janë vendosur vetëm në dy pika dhe aty ka qenë kodër dhe një lakesë e madhe dhe unë paskam gabua kur e kam vendosur murin, po në këtë sipërfaqe prej 74 m<sup>2</sup> e shfrytëzoj me disa fidanë për mbrojtjen nga rrëshqitja e dheut, dhe nuk kemi pasur ndonjë marrëveshje verbale nga ana e Komunës.

Në pyetjen e gjykatës i njëjti deklaron se në kohën kur e kam blerë parcelen me nr./18 dhe .../19 të njëjtat nuk kanë qenë të rrethuara, po ashtu i njëjti shton se jam i gatshëm që edhe sot kur të thot Komuna me largua murin.

Po ashtu gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të pandehuri A. G. dhe erdhi në përfundim se të njëjtit duhet falur besimi, pasi që mbrojtja e tij është në përputhje edhe me provat e tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, po ashtu nga mbrojtja e të pandehurit A. rezulton se i njëjti nuk e konteston faktin se e ka në posedim parcela me numër të njësisë 5004/1 pronë e Komunës së Pejës në sipërfaqe prej 74 m<sup>2</sup>, pa vetëdije dhe pa ditur saktësisht shtrirjen e parcelës e kam ndërtuar murin provizor vetëm sa për tu mbrojtur nga kafshët që sillen aty përreth mirëpo i njëjti shpreh se është i gatshëm me lirua menjëherë si të kërkohet.

I pandehuri B. S. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi se “ Kur kam vendos me bo murin kam fol me punëtorin dhe ja kam qit pikat ka me punua, nuk kam qenë prezent kur është bere ai gabim, pasi që nuk kanë punuar qysh i kam thënë unë por e kanë dëgjuar qysh i ka thënë N. K., dhe këtë parcelë e kam shitur që tri vite dhe nuk e kam në shfrytëzim e as pronar, Komunës ja kam falë 25 ari diku rreth 25 metra më lartë.

Në pyetjen e prokurorit të shtetit i njëjti deklaron Muri është ndërtuar diku në vitin 2014 në parcelën me nr.....-1 nuk kam tentuar të evitoi atë gabim, pasi që ajo pjesë e Komunës nuk shfrytëzohet nga askush dhe ajo rrugë nuk shfrytëzohet nuk ka kurrfarë qëllimi, por në qoftese është nevoja jam në gjendje që për tri ditë ta largoj atë muri.

Në pyetjen e gjykatës i njëjti deklaron se një pjesë të parcelës e kam blerë para luftës e këto dy parcelat i kam ble diku në vitin 1999 menjëherë pas luftës, kohën kur e kam blerë parcelën me

nr.6033-5 nuk kanë qenë të rrethuara sepse aty ka qenë breg dhe nuk ka pas kurgjo dhe në kohën kur e kam ndërtuar murin nuk e kam ditur që po ndërtohet në pronën e Komunës.

Si dhe me kujdes gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të pandehuri B. S. dhe erdhi në përfundim se të njëjtës duhet falur besimi, pasi që mbrojtja e tij është në përputhje edhe me provat e tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor përkatësisht dëshmitë e dëshmitarit Sh.P., ku faktin se këtu i pandehuri nuk kam qenë prezent kur është bërë muri rrethues pasi që nuk e kanë punuar sipas sugjerimeve të pandehurit që të bëhet muri sipas pikat, si dhe i njëjti nuk e konteston faktin se e ka në posedim parcela me numër të njësisë .../1 pronë e Komunës së Pejës në sipërfaqe prej prej 74m<sup>2</sup>, kur e kam ndërtuar murin nuk e kam ditur që po ndërtohet në pronën e Komunë po ashtu i njëjti shpreh së është i gatshëm me largua murin menjëherë si të kërkohet.

I pandehuri E. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë deklaroi së “Unë atë pronë që e kam aty e kam blerë në vitin 1985 apo 1986, atëherë ka qenë veshe dhe livadhe dhe nuk ka pas shpija dhe atëherë e di se ka qenë një derë e vogël ashti siç shihet në ekspertizë dhe unë nuk kam në posedim asnjë milimetër të pronës së Komunës.

Gjykata e vlerësoj mbrojtjen e të pandehuri E. K. dhe erdhi në përfundim se të njëjtës duhet falur besimi, pasi që mbrojtja e tij është në përputhje edhe me provat e tjera që janë administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare mbeti në tersi pran akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, duke shprehur bindjen se pas administrimit të provave materiale dhe personale u vërtetua përtej dyshimit mirë të bazuar se i pandehuri B. S. nga dt.11.12.2014 e gjerë më dt.30.04.2021, i pandehuri A. G. dhe B. K. që nga dt.11.12.2014 e tutje kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen, andaj prokurori propozoi që të pandehurit ti shpallët fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në pagurjen e shpenzimeve të procedurës penale.

Ndërsa sa i përket të pandehurit E.K., gjatë këtij shqyrtimi kryesor u vërtetua se i njëjti nuk është kryes i vepra penale cila i vihet në barë për faktin se nga ekspertiza gjyqësorë rezulton se i njëjti nuk mban apo shfrytëzon ndonjë pjesë të parcelës .../1 pronë e të dëmtuarës Kojua e Pejës, ashtu që në kuptim të dispozites ligjore të nenit 51 të KPPRK-së, heqi dorë nga ndjekja e mëtejme penale ndaj të akuzuarit E. K..

I pandehuri B. K. në fjalën përfundimtare deklaroi se “Në parcelën time nuk ka pemishte, aty kanë mundur të dalin disa bimë por pemishte nuk ka, në parcelën Komunës që është e ngjitur me parcelën time unë nuk kam vendosë kurrfarë murri por vetëm në hyrje ku lidhet edhe me parcelën time kam vendosur dyer për arsye që i kam dhënë edhe me herët për mbrojtje nga kafshët, unë as nuk e shfrytëzoj atë pjesë të parcelës sepse ajo është djerrinë. Besoj që Gjykata ka me i marr për bazë të gjitha këto dhe për faktin se asnjëherë më herët nuk kam pas precedent penale, dhe kurdo që kërkohet unë e largoj atë derë sepse nuk kam dëmtuar asnjë njeri e as pronën e shteti”.

I pandehuri A. G. në fjalën përfundimtare deklaroi se “Edhe një herë e përsërisë se pemët që janë të mbjella janë si mbrojtje nga rrëshqitja e dheut dhe jam i gatshëm kurdo që kërkohet që ta largoj atë murr”.

Mbrojtësi i të pandehurit B. S., av. Xhelal Radaoniqi ka përpiluar me shkrim dhe të njëjtën e ka dorëzuar në kopje të mjaftueshme për të gjitha palët në procedurë duke theksuar se nga deklarata e përfaqësuese së dëmtuarës Komunës në Pejë, pason përfundimi logjik juridik se në këtë çështje juridike nuk ka të dëmtuar andaj nuk ka as uzurpim, përndryshe në procedurën e paralajmëruar administrative të Komunës kjo rrugë publike të cilën gjeja e kanë uzurpuar të akuzuarit nuk do të figuron si rrugë publike. Kjo qasje e të dëmtuarës është ndikuar edhe nga fakti se një vend tjetër B. S. për rrugë ia ka falur Komunës diku 25 ari të pronës së vet private n, andaj i propozon gjykatës që të hedh aktakuzën e prokurorit të shtetit nga se mungon propozimi i kërkuar i të dëmtuarit.

Përfaqësuesja e Komunës në fjalën përfundimtare deklaroi nuk kam çka të deklaroi, në si Komunë e kemi dhënë përgjigjen me të cilën konstatohet se Kryetari i Komunës Gazmend Muhaxheri ka vendosur të mos ndjekë penalisht të pandehurit B. K. , A. G. , B. S. dhe E. K. për shkak të veprës penale Uzurpim i paligjshëm i pronës së luajtshme sipas nenit 332 par.2 të KPRK-së, duke theksuar se çdo person ose palë e interesuar për këmbim pronash apo marrje në shfrytëzim duhet të drejtohet zyrtarisht tek institucioni komunal përkatës për të arritur një zgjedhje ligjore dhe të drejtë në përputhje me ligjin dhe procedurat e përcaktuara.

- e) Vlerësimi përfundimtar i gjykatës në lidhje me çështjen(Vëndimi në lidhje me fajsinë);

Gjykata duke u bazuar në nenin 7 dhe nenin 8 par.2 të KPPRK-së i vlerësoj provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, duke analizuar me vëmendje fuqinë e tyre provuese, duke vlerësuar se si secila prove veç e veç dhe të gjitha së bashku vërtetojnë faktet relevante – vendimtare për të cilat ngarkohet i pandehuri dhe si rrjedhojë nxori përfundimet si në vijim.

Është vërtetuar pa asnjë dyshim fakti së të pandehurit B. K. , A. G. dhe B. S. janë në posedim të parcelës kontestuese, të përshkruar si në ekspertizë të ekspertit gjeodet.

Në këtë çështje penale nuk është vërtetuar fakti qendrorë që ishte pretendim i prokurorisë në aktakuzë, fakti se të pandehurit e kanë uzurpuar në mënyrë të kundërligjshme, përkatësisht e kanë pushtuar me dashje edhe vetëdije pronën kontestuese publik.

Në këtë rast gjykata vlerësoj se në lidhje me të pandehurit e parë mungon aspekti subjektiv i kësaj veprë penale, përkatësisht dijenia se të njëjtit janë duke e futur në kontroll pronën publike, pasi që të gjithë të pandehurit kanë treguar se në kohën kur kanë vendosur rrethojat e parcelave të tyre nuk e kanë ditur se janë duke e vendosur brenda hapësirës publike si rrjedhojë të të njëjtit ka munguar dashja për pushtimin e pronës publike, aq më tepër kur të gjithë të pandehurit kanë deklaruar që janë të gatshëm që menjëherë të largojnë rrethojat kufizuese të vendosura në pronë publike.

Sa i përket të pandehurit E. K. në bazë të raportit të ekspertit gjeodet u vërtetua se i njëjti nuk ka në posedim pronë që është publike, pora i njëjti mban në posedim vetëm pronën të cilën e ka në emër të tij, andaj mbi këtë bazë në lidhje me këtë të pandehur nuk plotësohet aspekti objektiv i kësaj veprë penale përkatësisht i njëjti nuk e ka vendos asnjëherë në posedim pronën publike.

Si përfundim, nuk ka mëdyshje se me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor u vërtetua të pandehurit nuk e kanë kryer veprën penale e cila u ngarkohet.

f) Shpenzimet procedurës dhe kërkesa pasurore juridike;

Kur u vendos në lidhje me shpenzimet e procedurës gjykata u bazua në nenin 453 par.1 të KPPRK-së, ku thuhet “Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1

deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”.

Në bazë të nenit 462 par.1 të KPPRK-së, e dëmtuara u udhëzua qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontët të rregullt civil.

Andaj, duke u mbështetur në të thënat si me lartë dhe në kuptim te nenit 363 par.1 pika 1.1 dhe neni 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMLORE PEJË**

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.560/15, me datë 27.02.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale  
Teuta Spahija

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.